



REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01nr 900-8822

Dt: 15.02.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 8,9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale dhe Përfundimit Nr.06-7288-9/1 i miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të dt. 09.02.2016, më të cilin është aprovuar kërkesa e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për subvencionimin e aktiviteteve të OJQ "Radio Prosperiteti", me dt. 15.02.2016 e miraton këtë

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për subvencionimin e aktiviteteve të OJQ "Radio Prosperiteti", evidentuar me nr. 16-400-7138 e dt. 08.02.2016, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 2,000.00€.

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 2,000.00€ nga subvencionet e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e OJQ "Radio Prosperiteti" nr. 2018000020712682 - TEB Bank.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

4. Vendimi iu dërgohet :

- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Z. Lendrit Qeli, koordinator i "Radio Prosperitetit" , Rr. "A.P. Tepelena" pa nr, Gjakovë
- Arkivët

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari - Lila